



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.184/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e Shkalles se Dytë, me gjyqtarin Ramush Bardiqi, ne çështjen juridike përmbarimore të kreditorit F-Shped Shpk me adres Dardani Leke Dukagjini Prishtine, te cilin e përfaqëson L.M. avokat, ndaj debitorit “Enertech SHPK rr. Nail Hyseni nr. 22- Prishtinë, bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore ne Prishtine, PPP.nr.1211/21 të datës 26.01.2022, me datën 18.07.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e kreditorit F-Shped Shpk me adres Dardani Leke Dukagjini Prishtine, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore ne Prishtine, PPP.nr.1211/21 të datës 26.01.2022, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykatës Themelore ne Prishtine, me aktvendimin PPP.nr.1211/21 të datës 26.01.2022, e ka pranuar si te bazuar prapësimin e debitorit, ka shfuqizuar urdhrin përmbarimor Pnr.nr.553/2021 të datës 20.09.2021, i lëshuar nga Përmbaruesi Privat..

Kundër këtij aktvendimi, ka paraqitur ankesë kreditori, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës përmbarimore, vërtetimit te gabuar dhe jo te plotë te gjendjes faktike dhe shkeljes se te drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkalles se dytë ta aprovoj këtë ankesë si te bazuar, aktvendimin e ankimuar te anuloj, te refuzohet prapësimin e kreditorit dhe te mbetet ne fuqi përmbarimor Pnr.nr.553/2021 të datës 20.09.2021.

Dhoma e Shkalles se Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (LPP), gjeti se:

-Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori, ka paraqitur propozim për përmbarrim ndaj debitorit, në baze të faturave me nr.36389 dt. 20.05.2021, 33749 dt. 11.05.2021 nr. 33731 dt.11.05.2021, 33720, 33680, 33591 dt.11.05.2021. Përmbarruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, me urdhrin përmbarrimor Pnr.nr.553/2021 të datës 20.09.2021, i ka lejuar përmbarrimin, me të cilën detyrohet debitori që kreditorit në emër të borxhit që rrjedh nga faturat t'i paguaj shumën 520€, me kamat ligjore 8% si dhe shpenzimet procedurës përmbarrimore.

Kundër urdhrin përmbarrimor debitori ka paraqitur prapësim me pretendimin se të ndërprite procedura dhe lënda të dërgohet në gjykatë të rregull

Gjykatës Themelore në Prishtinë, me aktvendimin e ankimuar, e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar. Në arsyetim të aktvendimit të atakuar ka theksuar se në shkresat e lëndës nuk ka dëshmi se faturat mbi bazën e se cilave është lejuar përmbarrimi nuk janë pranuar nga debitori, të njëjtat fatura nuk janë nënshkruar nga personi-subjekti në emër dhe mbiemër dhe si të tilla nuk përbejnë bazë për përmbarrim, ndërsa kreditori nuk ka mundur të argumentoj pretendimet e tij me asnjë provë të cilat do të ndikonin në një vendosje ndryshe nga ka vendosur në dispozitiv të aktvendimit.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkalles së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbarrimore kur e ka aprovuar prapësimin e debitorit, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përmbarrimi është lejuar në bazë të faturës së lëshuar nga kreditori, e cila faturë nuk përmban elementet që kërkohen me nenin 29 paragrafi par.3 i cili përcakton se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarrim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*.

Gjykata e shkalles së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim në pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe gjykata e shkallës së dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj gjykatë i rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar. Gjykata e shkalles së dytë bazuar në Udhëzimin administrativ Nr.15/2010 Për Zbatimin E Ligjit Nr. 03/L-222 Mbi Administratën Tatimore Dhe Procedurat, i cili në nenin 20 par.1 nenpar.1.17 parasheh që *“Në minimum, një faturë duhet të jetë e nënshkruar nga shitësi, nëse klienti apo blerësi është dispozicion për të nënshkruar, ai person duhet po ashtu të nënshkruajë faturën tatimore”*, konsideron se faturat si dokumente në sajë të cilave kreditori kërkon përmbushjen e detyrimit nga debitori, nuk ka prova se janë pranuar nga debitori, të njëjta nuk janë nënshkruar nga debitori në mënyrë që të konsiderohen si dokumente të besueshme, ndërsa vlerëson se me të drejtë gjykata e shkalles

se parë ka vlerësuar se kreditori ne rastin konkret nuk ka ofruar prova juridikisht te vlefshme ne mbështetje te pretendimeve te tij.

Përndryshe në procedurën përbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përbarimin.

Kompetenca e Dhomës se Shkalles se Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,
Dhoma e Shkalles se Dytë
K.DH.SH.II nr.184/23, me datë 18.07.2023

Gjyqtari,
Ramush Bardiqi